



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:241952

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05616478

2021:241953

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit **I.H.** nga fsh ..., Komuna e Shtimes, të cilin me autorizim e përfaqëson av Islam Gashi nga Lipjani, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi me autorizim L.M. nga Shtimja, në çështjen juridike, kompensim i shtesës në pagë sipas licencimit, vlera e kontestit 1,638.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 24 Prill 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit I.H. si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, që paditësit **I.H.**, me numër personal ..., për periudhën nga data 12.10.2018 deri më 12.10.2021, t'ia kompensojë shumën prej 1,638.00€ (Një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë euro), në emër të shtesës në pagë, sipas gradimit përkatësisht licencimit. Shuma e aprovuar duhet të paguhet me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë 28.10.2021, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 135€ (njëqind e tridhjetë e pesë euro), të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datë 28.10.2021, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj kërkesëpadinë, ashtu që paditësit t'ia kompensojë mjetet në emër të shtesës sipas kualifikimit, licencimit, për periudhën nga data 12.10.2018 deri më 12.10.2021, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës. Kërkesën e ka bazuar në

Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë dt. 18.04.2017 sipas nenit 7, nenit 1.3 nga të cilat dispozita paditësit i takon kompensimi në pagë sipas kualifikimit në përqindje 27% e pagës bazë, ndërsa e paditura deri më tani nuk e ka kompensuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit është e pabazuar, pasi që kontrata kolektive e nënshkruar më dt. 17.04.2017 dhe 22.01.2021, nuk janë më në fuqi. Për të gjitha këto arsye pala e paditur ka konsideruar se padia dhe kërkesëpadia nuk kanë bazë ligjore. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe të parashkruar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë së paditësit, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e përfaqësuesit të të paditurës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 398, të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398, të LPK-së, për marrjen e aktgjyqimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398, të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë sepse e njëjta bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Po ashtu, Gjykata gjeti se në mes të palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në Gjimnazin “N.F.” në Shtime, e që ky fakt gjen mbështetje edhe në Kontratën e punës dhe diplomën e fakultetit të paditësit.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës në përgjigjen në padi, sa i përket bazës ligjore se Kontrata kolektive më nuk është në fuqi dhe se nuk ka mundësi budjetore për pagesë, Gjykata

ka vlerësuar se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Sa i përket çështjes se kontrata kolektive më nuk është në fuqi, Gjykata mori parasysh faktin se kërkesat sipas padisë rrjedhin për kohën sa kontrata kolektive ka qenë në fuqi. Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Me qenë se nuk ka qenë kontestuese marrëdhënia e punës dhe niveli i kualifikimit të paditësit, Gjykata nuk është lëshuar në analizimin e fakteve të tilla, pasi për palët ndërgjyqëse nuk kanë qenë kontestuese.

Nga këto pretendime Gjykata ka vlerësuar se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit bazohet në Kontratën Kolektive të Arsimit, e vitit 2017 dhe 2021, respektivisht nenit 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe 21.04.2021, të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në të cilën është paraparë shprehimisht se: “Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit sipas pikës 1.3 të këtij neni është paraparë se mësimdhënësi me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë”. Vendimi i Qeverisë, Nr.01/33, i datës 29.08.2008, shprehimisht në pikën 4.3 parasheh se; mësimdhënësit, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet, përfitojnë një rritje page bazë prej 27%. Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr. 214/2023, i datës 09.10.2023, në pikën I. të tij ka paraparë se: “Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.”

Ndërsa sa i përket pretendimit se Ministria e Arsimit ka marrë obligim që ti ndihmoj komunat me buxhet shtesë gjykata vlerëson se kjo është çështje e brendshme e koordinimit të institucioneve dhe nuk ndikon në detyrimin që ka pala e paditur ndaj palës paditëse në këtë rast. Kjo ngase në bazë të kontratës Kolektive të vitit 2017 dhe 2021, organe zbatuese sipas nenit 2 par 1.2 janë DKA të Komunave përkatëse.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh edhe faktet jokontestuese nga palët ndërgjyqës në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar sikurse në pikën I. dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e paraqitura ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura. Lartësia e kërkesëpadisë u mbështet në listën e pagave përmes të cilës u vërtetua shuma se sa është paguar paditësi në emër të licencimit që është shuma prej 78.43€ që është paguar, ndërsa diferenca e papaguar është 45.50€ (e cila del nga llogaritja e thjeshtë nga paga bazë $459 \times 27\% = 123.93 - 78.43 = 45.50$ x 36 muaj = 1,638,00 euro).

Andaj, nga të gjitha të lartcekurat dhe bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, gjykata ka vlerësuar se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në shtesës në punë sipas kualifikimit shumat e papaguara dhe se e njëjta është e legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi nga ana e të paditurit.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqës dhe ka gjetur se të njëjta janë pa ndikim në zgjidhjen e çështjes ndryshe përtej asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj, duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratave Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësit është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumat e specifikuar në pikën II të dispozitivit.

Si përfundim, Gjykata ka gjetur se e paditura ka pasur detyrim që paditësit t'ia përfshijë në pagë edhe shtesën prej 27% të pagës bazë në emër të shtesës sipas kualifikimit, të cilën gjë nuk e ka bërë për periudhën kontestuese, në njërin anë kurse në anën tjetër edhe paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 sa i përket licencimit dhe nenit 8 të LMD-së, ku thuhet se “Pjesëmarrësit në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditësit. Në rastin konkret gjykata i zbatoi dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L/212 ku shprehimisht thuhet “Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshje te tillë kolektive”. Andaj edhe Gjykata duke i marr për bazë faktet e cekura më lart, vendosi sikurse në dispozitiv

të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë, me datë 28/10/2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020, të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata, lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, është bazuar në dispozitat e nenit 452, par 3 dhe nenit 463, të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së cekur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimit, e të cilat shpenzime përfshijnë, përpilimin e padisë në shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 31 euro, që në shumë të përgjithshme janë 135.00€, të cilët po ashtu duhet t'i paguhen paditësit në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398, të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL

C.nr. 2021:241953, me datë 24 Prill 2024

Gjyqtari

Faton Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.